



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi nga ministri i Mjedisit dhe Turizmit i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” .

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Robert Bitri, Tatiana Nurçe, Gjetan Gjetani, Ilir Ndraxhi, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Kujtim Gjuzi, Klajdi Qama, Zef Shtjefni dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Halit Valteri, Lefter Koka dhe Andrea Marto.

Të ftuar:

Blendi Klosi – Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Vilma Kola – përfaqësuese e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Rovena Mocka - përfaqësuese e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Elsid Xhelili - përfaqësuese e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese të Tregtisë dhe Mjedisit, datë 19.11.2019, ora 10:30.

Kemi vazhdimin e prezantimit të buxhetit.

Sot kemi ministrin e Mjedisit dhe Turizmit, zotin Klosi, i cili do të prezantojë pjesën e turizmit dhe mjedisit në kuadrin e projektligjit të buxhetit të vitit 2020.

Relator është zoti Ilir Beqaj.

Po e fillojmë prezantimin nga ministri, pastaj relatori, në fund do të vazhdojmë me pyetje dhe diskutime nga të gjithë anëtarët.

Urdhëroni, zoti Ministër!

Blendi Klosi – Të nderuar kolegë, diskutimi për sa i përket projektbuxhetit të vitit 2020 për të dy sektorët, pra qoftë për turizmin, qoftë për mjedisin, pa dyshim është një diskutim kompleks, i cili nuk mund të përfaqësohet vetëm nga shifrat dhe nga zërat buxhetorë që ka Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, por besoj se gjatë gjithë diskutimit që do të ketë ky komision me kolegët, do të ballafaqohen, faktet që pothuajse të gjitha institucionet që kanë fokus të drejtpërdrejtë turizmin, natyrën dhe mjedisin, duke marrë investime të jashtëzakonshme për sa u përket dy sektorëve, qoftë turizmit dhe qoftë mjedisit. E them këtë, pasi politikat për turizmin në vendin tonë, janë politika, të cilat falë edhe kontributit të parlamentit shqiptar, falë edhe diskutimeve të përditshme që ne kemi në jetën politike-parlamentare, por edhe administrative të vendit për turizmin e kanë shndërruar sektorin e turizmit në një industri të vërtetë, e cila ka marrë vëmendjen në të gjitha aspektet. Besoj se kolegët, ministra, por sidomos Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Shëndetësisë, ministria që mbulon arsimin dhe arsimin profesional, Ministria e Ekonomisë dhe institucione të tjera, kur të vijne për diskutime në këtë komision, do të dëshmojnë për zëra buxhetorë të vërtetë, të cilët ndryshojnë infrastrukturën e vendit në shërbim të turizmit. Investimet e mëdha infrastrukturore që do të kalojnë drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit, por edhe në bashkëpunim me pushtetin lokal dhe nga bashkëpunimi me dy projektet e mëdha të Bankës Botërore dhe të Bashkimit Europian, kanë një sasi të konsiderueshme parash me të cilat do të bëhen investime konkrete në vitin 2020, duke shndërruar disa nga bashkitë e vendit, që janë pjesë e kësaj pakete të Bankës Botërore dhe Bashkimit Europian për forcimin e dimensionit turistik, realisht në destinacione turistike të qëndrueshme. Do të kemi investime në disa bashki të vendit të përcaktuara prej disa kohësh, por që bëhen aktive këtë vit për sa i përket fuqizimit të investimeve në turizëm.

Po ashtu, në kuadër të politikave të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të nderuar kolegë deputetë, 1 vit më parë përsëri kemi qenë së bashku në këtë diskutim, në kuadër të disa iniciativave që ne ndërmorëm për lehtësim fiskal të sektorit të turizmit, të cilat kanë qenë të herëpashershme në qeverisjen 6-vjeçare të Edi Ramës dhe të Partisë Socialiste dhe të koalicionit të saj në 4-vjeçarin e parë dhe të Partisë Socialiste këta dy vjet të cilat realisht kanë shënuar një kthim të vëmendjes drejt turizmit. Kështu, kujtojmë reduktimin në 6% të menaxhimit të hotelerisë dhe, po ashtu, politikat që bëmë për hotelet me 5 vje.

Për vitin 2020 presim që të kemi realisht investime shumë më të shumta në këtë industri. Kemi investime në hoteleri në të gjithë vendin. Nëpërmjet politikave që kemi bërë këtu në parlament së bashku me ju, kolegë deputetë, kemi nxitur një sektorë të tërë në ekonominë e vendit tonë.

Po ashtu, sot operojnë zyrtarisht në vendin tonë një numër i konsiderueshëm hotelesh me 5 vje, brende të njohura, të cilat tashmë kanë lidhur kontratat dhe janë në përfundim të investimeve të tyre për të pasur edhe në Shqipëri, si në të gjithë vendet e tjera normale turistike evropiane, një numër të konsiderueshëm brendesh. Sot kemi “Hilton”, “Hajat”, Merjot, “MK Group”, “Melia Group”, “Meritime Group”, të cilët janë investime reale në vendin tonë dhe që e fusin Shqipërinë në hartën e hoteleve me 5 vje.

Për sa u përket politikave që kemi miratuar së bashku vjet në buxhetin e vitit 2019 që tashmë janë reale, është politika për agroturizmin. Kemi zhvilluar dhe do të vazhdojmë ta mbështesim këtë dimension edhe për vitin 2020 dhe tashmë nuk është vetëm një premtim apo një politikë e diskutuar, por një politikë e realizuar ajo çfarë kemi realizuar në kuadër të agroturizmit. Kemi mbi 19 subjekte, të cilat kanë marrë statusin e lehtësisë jo vetëm në investim nëpërmjet fondeve të ABZHR-së, por tashmë edhe lehtësira fiskale, të cilat veprojnë nga Veriu në Jug, si pika të vërteta agroturistike. Nëpërmjet këtyre 19 simboleve të para shpresojmë dhe kemi bindjen e thellë që edhe në kuadër të projektit “IPARD” që tashmë është në thirrjen e tij të dytë, të kemi mundësinë që ta promovojmë këtë dimension dhe të shtojmë me shpejtësi pjesën e agroturizmit, e cila do të krijojë një sinergji jo vetëm për zhvillimin turistik, por edhe për ekonominë e zonave rurale edhe në vitin e ardhshëm.

Për sa u përket atyre që do të bëjnë nëpërmjet këtij buxheti me të gjitha politikat për turizmin, ajo që ne kemi thënë shpesh është dalja nga sezonaliteti. Viti 2019 po shënon përsëri një rritje të konsiderueshme të numrit të turistëve të huaj që vijnë në vendin tonë. Në ditët që flasim është arritur të kalohet me të paktën 100 mijë numri i turistëve të vitit të kaluar: nga 5,9 milionë turistë, që kanë hyrë në Shqipëri. gjatë gjithë vitit 2018, sot kemi shkuar në 6 milionë turistë, të cilët kanë hyrë në Shqipëri. Po të kemi një rritje të

konsiderueshme edhe në muajin dhjetor, besoj se do të shkojmë deri në 6,4 milionë të turistë të huaj që hyjnë në Shqipëri gjatë vitit 2019, duke shënuar një rritje me rreth 10% e krahasuar me vitin 2018. Kjo për ne është një arritje e konsiderueshme.

Por, pa dyshim, kemi nevojë prandaj them që me të gjitha politikat që do të ndjekim edhe në kuadër të buxhetit të vitit 2020, ne ta shtojmë këtë hapësirë për të pranuar më shumë turist të huaj në Shqipëri, për ta shtrirë sezonin turistik dhe për të dalë nga sezonaliteti. Pasi kemi nevojë që me këto investime të mëdha, që po bëhen nga një komitet i gjerë biznesmenësh shqiptarë në hoteleri në vendin tonë, të kemi mundësi që ta rritim me ekonominë, pra të keni numër të shtuar turistësh që hyjnë në Shqipëri dhe që vijnë në 12 muajt e vitit. Këtë kemi pasur sukses në vitin 2019. E thashë, me rritjen e numrit të turistëve, por edhe me rritjen e pasaportave që hyjnë në Shqipëri, kemi shkuar në 65 pasaporta të huaja, pra 65 kombësi për vitin 2019, duke shënuar një rritje edhe në këtë drejtim për sa i përket sezonit të turizmit. Ajo çfarë duam të bëjmë në vitin 2020, në kuadër politikave të ndjekura edhe të mbështetura nga ky projektbuxhet, është kategorizimi strukturave akomoduese dhe luftë kundër informalitetit, pra formalizimi gjithmonë e më të madh të gjithë industrisë së turizmit, i cili është një problem jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon dhe më gjerë se sa rajoni për të luftuar informalitetin në këtë industri. Por ajo që duam të rrisim shumë është shtimi i gamës së festivaleve rinore në vendin tonë dhe vitin e kaluar kemi qenë realisht shumë mirë. Në vitin 2018 kishim vetëm një festival, në vitin 2019 kishim katër festivale europiane gjatë vijës bregdetare dhe duam që të shkojmë në 10 në vitin 2020. Por në vitin 2020 të mos kemi vetëm në bregdet, por të kemi edhe në zonën kontinentale shqiptare, rritje të numrit të festivaleve rinore.

Projekti ynë i madh për vitin 2020, në kuadër të fushës së turizmit, është turizmi blu. Duam që me politikat, që do të zhvillojë ministria për vitin 2020 (dhe këtu do të donim që të kishim diskutim me komisionin, pasi të kalojmë procedurën e miratimit të buxhetit të vitit 2020) do të kërkonim një sërë ndryshimesh ligjore në kuadër të hapjes së Shqipërisë për turizmin detar. Sot mund të themi me keqardhje që i kemi pothuajse zero të ardhurat, që vijnë nga turizmi i detit. Pra, turizmin blu pothuajse e kemi inekzistent. Prandaj kemi shumë nevojë që nëpërmjet kontributit, që do të japë Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, ta zgjerojmë këtë dimension të politikave të turizmit në vendin tonë. Në qoftë se do të kemi mundësinë që të krijojmë një sistem turizmi marinë në vendin tonë, të keni bindjen se këtu bëhet fjalë më shumë për ndryshime ligjore, për lehtësira fiskale, për lehtësira procedurale, të cilat mund të ndihmojnë fare mirë që të hapet një dimension i ri në turizmin shqiptar, i munguar që të paktën t'i dyfishojë të ardhurat që vijnë në buxhet nga sektori i turizmit. Ajo që mund të

themi, për informacion të kolegëve deputetë, është që me një lëvizje, që ne realizuam me punën e përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes për sa i përket pastrimit të hartave të Shqipërisë nga zona të minuara për turizmin detar, sot Shqipëria ka ndryshuar edhe në hartat ndërkombëtare, si zona të sigurta për lundrim. Kjo besoj që në vitin 2020 do të shënojë një rritje të konsiderueshme të jahteve dhe turizmit detar që do t'i afrohen Shqipërisë për të shtuar të ardhurat në ekonomi. Pra, për të mbyllur sektorin e turizmit, mendoj më shumë nxitje të sektorit, më shumë politika të përbashkëta me komunitetet lokale dhe qendrore, me politika, të cilat krijojnë hapësira të reja që ka Shqipëria për të bërë turizëm dhe për ta shtrirë turizmin në 12 muajt e vitit dhe për të dalë nga sezonaliteti. Besoj se do të jenë objektivat kryesorë, të cilët edhe në buxhetin total të qeverisë për vitin 2020, kanë gjetur mbështetje me investime të mëdha në infrastrukturë dhe hapjen e Shqipërisë për biseda më të gjera në fushën e turizmit.

Për sa i përket pjesës së mjedisit, edhe pjesa e mjedisit, paçka se është më shumë pjesë që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit, në konceptin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit kemi ndërmarrë një sërë iniciativash, që kanë të bëjnë me reformimin e sistemit. Unë për këtë kam folur në komisionin tuaj edhe para pak ditësh, por shumica e veprimeve që kemi ndërmarr tashmë janë bërë realitet. Kemi një reformim të sistemit të mbrojtjes së mjedisit në Shqipëri, po ashtu edhe një ridimensionim të vetë shoqërisë në nxitjen dhe mbrojtjen e tyre.

Gjatë vitit 2020 ne do ta vazhdojmë fushatën tonë për ta reformuar të gjithë sistemin e mbrojtjes së mjedisit. Ashtu siç ju kam informuar, tashmë është në procesin e miratimit qeveritar dhe aprovimi i lehtësimit të të gjithë sistemit, duke reduktuar një grup të madh lejesh mjedisore, të cilat janë vendosur pa të drejtë biznesit të vogël në kurriz dhe e kanë dëmtuar raportin e gjithë sistemit të mbrojtjes së mjedisit me ndotësit e vërtetë.

Po ashtu, kemi fushatën e vitit 2020, që për ne është shumë e rëndësishme; fushata që Shqipëria të jetë vendi i parë pa qese plastike në Europë. Tashmë është në fazën e diskutimit qeveritar me komunitetin dhe me donatorët e gjithë procesit që mund ta realizojnë që të kemi një fushatë të suksesshme që realisht Shqipëria të bëhet pjesë e një lufte të vërtetë për mbrojtjen e mjedisit.

Në kuadër të investimeve që vijnë edhe nga Ministria e Infrastrukturës për sa i përket ndërtimit të *landfill*-eve në zonat që mungojnë do të vazhdojnë investimet për rehabilitimin e venddepozitimeve ilegale, që është një shqetësim i madh. Ne me buxhetin e vitit të r, do të përpiqemi që të kemi investime nga disa sektorë në risistemimin e të gjitha venddepozitimeve në 61 bashkitë e vendit, duke e rritur edhe kontrollin mbi bashkitë, të cilat kanë detyrë të parë dhe kryesore pastrimin dhe futjen në sistem ligjor të trajtimit të mbetjeve

urbane, pasi sot fatkeqësisht në 61 bashkitë e vendit kemi problematika të theksuara për sa u përket venddepozitimeve. Me buxhetin e vitit 2020 fokusi i investimeve të Ministrisë së Mjedisit do të jetë në këtë aspekt, pra për të larguar venddepozitimeve nga shtretërit e lumenjve, për të mbyllur venddepozitimet ilegale, për të mbyllur ato çfarë ish-komunat i kishin lënë ende aktive, si venddepozitime ilegale, për të krijuar së bashku me bashkitë nga donatorët dhe me sa të kem mundësi nga buxheti i shtetit, brenda vitit 2020 një sistem legal, të licencuar me leje jo vetëm nga këshillat bashkiakë por edhe me leje mjedisore dhe me leje operimi për një sistem funksional në 61 bashkitë për trajtimin mbetjeve e urbane. Shirat e këtij sezoni dëshmuar edhe një herë që lumenjtë, përdoren ende nga bashkitë në mënyrë joligjore. Por pas ndryshimit të Kodit Penal, tashmë shihet si problem penal dhe si detyrim penal i kryetarëve të bashkive për të mos i përdorur më lumenjtë si venddepozitime. Me pak shi që ra në ditët e fundit të këtij sezoni shirash u dëshmuar se përsëri bregu i detit dhe breglumenjtë janë mbushur me plastikë, të cilat duhet të refuzohen dhe duhet të reduktohen, por që vazhdon të kemi një sistem joligjor, jolegal të trajtimit të mbetjeve urbane, për të cilat ne në vitin 2020 duhet të jemi shumë më tepër radikalë.

Viti 2020 shënon planin tonë të madh “Clean&Green 2020” për të pasur mundësinë që Shqipëria të shkojë më e pastër dhe më e gjelbëruar në vitin 2020. Pra, deri në fund të vitit 2020, të shkuar në 20 milionë dhe 200 pemë të mbjella në Shqipëri, një shifër, e cila, për mua, tashmë, pasi kanë kaluar 2 vjet plotësisht, e realizueshme. Kemi një fushatë reale gjatë sezonit të mbjelljeve në të gjitha bashkitë, që janë të involvuara për ta shtuar këtë, por kemi shumë nevojë që edhe nëpërmjet zgjerimit së gjithë debatit jo vetëm në shqiptar, por edhe europian, për mjedisin, për natyrën, për shtimin e fushatës së mbjelljeve dhe për luftën kundër erozionit. Në kuadër të përpjekjeve që ne bëjmë për fushatën kundër ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike, Shqipëria të marrë investimet e konsiderueshme. Nëpërmjet projekteve donatore ne kemi shtuar investimet edhe në këtë fushë dhe kemi mundësinë që sot në vitin 2020, pra në sezonin 2019-2020, por edhe 2020-2021 të kemi një fushatë më të madhe për sa i përket mbjelljes së pemë në Shqipëri, duke e çuar në një stad tjetër fushatën tonë “Clean&Green 2020” për të realizuar me sezonin e mbjelljeve të vitit 2020, pra me vjeshtën e vitit 2020, objektivin tonë të madh për 20 milionë e 200 mijë pemë në vendin tonë.

Të nderuar kolegë, këto ishin disa nga përpjekjet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, që siç e thashë është e vështirë të gjenden në shifrat e buxhetit që i takojë kësaj ministrie, por të shtrirë në të gjithë zërat buxhetorë të ministrive të tjera. Ju bëj edhe një herë thirrje, kolegë deputetë, që pasi të mbarojmë diskutimin për buxhetin, ne të përfshihemi në fushatën tonë të madhe që Shqipëria nuk është e ndotur, por është e papastër dhe për këtë

papastërti të gjithë mund të japim një kontribut, duke kontribuar që Shqipëria, nëpërmjet disa mekanizmave fare të thjeshtë që bota i ka bërë prej shumë kohës, të jetë e pastër në fillimin e sezonit të vitit 2020.

Viti 2020, në qoftë se do të kemi këtë trend rritje të investimeve në hoteleri, me këtë trend rritje së promovimit të Shqipërisë turistike, me këtë trend të fushatës sonë për të pasur një Shqipëri të pastër në pranverën e vitit 2020, pra në fillim të sezonit turistik, besoj se do të jetë një vit shumë më i suksesshëm për sa i përket numrit të turistëve të huaj që vijnë në vendin tonë, por edhe viti i tretë, pra vitet 2018-2019 dhe 2020, që ka po të njëjtën qëndrueshmëri dhe një rritje të konsiderueshme të paktën me 10% të pasaportave të huaja që hyjnë në vendin tonë. Pa dyshim, do ta fusin Shqipërinë në një destinacion të qëndrueshëm dhe pas 3 vjetësh kontratat bëhen më të qarta dhe destinacioni bëhet më i mirëmbajtur nga pikëpamja e tij. Prandaj kemi shumë nevojë që të mos gjykojmë vetëm mbi shifrat e buxhetit, por të gjykojmë mbi politikat që kanë të bëjnë me këtë sektor, pasi realisht është sektor, i cili, siç e thashë në fjalinë time të parë, shtrihet në pothuajse të gjithë zërat buxhetorë të këtij buxheti. Çdo investim, që tashmë po bëhet, ka një dimension për t'i shërbyer turizmit në të gjitha aspektet, qoftë rritja me 100 e pikave të shërbimit shëndetësor në shkallë vendi, sidomos në zonat turistike, qoftë në investimet e mëdha infrastrukturore të parashikuara për vitin 2020: investimet në aeroporte, investimet në infrastrukturë, qoftë investimet që po bëhen për rritjen e arsimit profesional që përsëri është një dimension. Ky komision ka shumë nevojë që t'i mbajë ndezur edhe diskutimet e mëtejshme qoftë për investimet që bëhen në të gjithë sektorët që kanë të bëjnë drejtpërdrejt ose indirekt me turizmin. Pra, mendoj se ka ardhur koha që realisht të mendojmë për një industri, e cila ka shumë nevojë për mbështetje buxhetore për të promovuar Shqipërinë turistike dhe natyrën e bukur të vendit tonë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin!

Fjalën e ka relatori zoti Beqaj dhe më pas vazhdojmë me pyetjet.

Ilir Beqaj - Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin!

Në qoftë se do ta lidhim diskutimin e tanishëm me mbledhjet që kemi bërë dje, besoj se buxheti i infrastrukturës dhe i energjisë, që kemi në orën 12:00, lidhet ndjeshëm edhe me turizmin.

Unë dje thashë se i gjithë buxheti, në vlerësimin tim, është prudent. Edhe pse të bujqësia kishim një buxhet optimist në buxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe të Mjedisit, në vlerësimin tim të mjedisit, mbetemi brenda kuadrit të prurës, por tek turizmi, mendoj se jemi shumë pak prezentë me buxhetin e programit përkatës të Ministrisë së Turizmit.

Sigurisht, edhe infrastruktura rrugore, energjetike, trajtimi i mbetjeve të ngurta, furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimet me ujë të ndotur, formimi profesional dhe politikat fiskale janë turizëm, edhe transporti ajror, edhe marinat...

Për momentin transporti hekurudhor është ende tek transporti i mallrave, por lehtëson rrugët. Megjithatë, unë besoj se tek turizmi, ndoshta kur të vijë diskutimi nën për nën, ne duhet të rindalemi, sepse, në qoftë se vitin e ardhshëm, me një vlerësim normal do të duam të kemi 7 milionë turistë, 250 lekë të vjetër për turist nuk mjaftojnë. Ka 2-3 vjet që nuk mund të jemi më destinacion i pazbuluar, sepse në qoftë se vit pas viti rritim zbulueshmërinë si destinacion, konkurrenca na bëhet më e fortë. Për të mbajtur ritmin aktual, por edhe për t'u rritur, siç kemi nevojë, meqenëse është një nga sektorët kryesorë që ndikon në ekonomi, në punësim, në bilancin tregtar të vendit dhe për pasojë edhe në qëndrueshmërinë e monedhës, duhet të jemi, praktikisht, më aktivë në promovim. Në botën e sotme, me konkurrencë të madhe botërore edhe pëllgun e Mesdheut, nuk mund ta bëjmë këtë punë, për mendimin tim, me këtë buxhet që është këtu.

Në pjesën e mjedisit, qoftë të pyjet, qoftë të programet e mjedisit, trendet janë përgjithësisht normale brenda kuadrit prudent që ka i gjithë buxheti i vitit 2020 i paraqitur nga qeveria. Sigurisht që hyjmë në vitin e tretë të politikave promovuese që i bëmë turizmit me incentiva fiskale, qoftë me TVSH-në, qoftë me lehtësim fiskal për hotelet me 5 vje dhe me emra ndërkombëtarë, por duhet një përpjekje më e shënjestruar për promovim. Praktikisht, promovimi ka filluar dhe ministri ka qenë në panairin e Londrës, pikërisht për vitin e ardhshëm, jo vetëm për tri vitet e ardhshme, por ne do të duhet që të jemi shumë më aktivë dhe shumë më prezent, duke shfrytëzuar qoftë fatin që jemi në pëllgun e Mesdheut, qoftë rritjen e kërkesës drejt Mesdheut të flukseve turistike nga Azia e largët. Siç e tha edhe ministri, pozicioni na ndihmon të synojmë një shtrirje sa më të gjerë gjatë gjithë sezonit, por nuk duhet ta lëmë mënjanë faktin se, në qoftë se sot një dimension, të paktën në numër, jo në ditë, e kemi nga shqiptarët e trojeve, duhet të jemi të gatshëm në një moment të afërt që kur në Kosovë të liberalizohen vizat, atë ditë pushimi sa kosovarët bëjnë, nuk është e thënë që të vazhdojnë t'i bëjnë kur të jenë me viza të liberalizuara. Prandaj duhet të përgatitemi sesi këtë rënie të pritshme ta kompensojmë me flukse të tjera, sepse jam i bindur se aeroporti i Vlorës do të fillojë vitin tjetër, por për të përfunduar do kohën e vet; edhe aeroporti i Kukësit nuk përfundon vitin e ardhshëm; edhe marinat, për të cilat janë dhënë lejet, nuk përfundojnë vitin e ardhshëm, por, siç e tha edhe ministri, duhet të bëhemi gati të kemi marrëdhënie disavjeçare, në mënyrë që të jemi shumë më të sigurt se çfarë presim të vijmë dhe pastaj t'u përgjigjemi edhe ne. Nëse vijnë flukse **4-vjeçare**, duhet të shohim se si mund t'i prioritojmë

investimet në funksion të rrugëve, të ujit të pijshëm, të mbetjeve të ngurta, të ujërave të përdorura dhe kanalizimeve, të energjetikës, të formimit profesional, qoftë edhe për forma të tjera, siç ministri e tha me të drejtë që potenciali më i madh që kemi, ende i pashfrytëzuar, është deti. E përmendem dje te mungesa ende e hartës së kultivimit të peshkut në det, por ende vazhdojmë ta kemi detin një nga potencialet më të mëdha, ose ende të fjetura.

Faleminderit!

Niko Peleshi- Faleminderit, zoti Beqaj!

Zoti Baraj, fjala për ju.

Besnik Baraj – Unë kam një koment të shkurtër. Është interesante që për vende me këtë stad zhvillimi si Shqipëria, ndërsa bëhen avancime në drejtim të adoptimit të një legjislacioni adekuat mjedisor, kur vjen puna për të zgjidhur qesen, në mënyrë që të bëhen të mundura realizimet e këtyre ligjeve, shtete të ngjashme si Shqipëria investojnë jashtëzakonisht pak, pothuajse në mënyrë të papërfillshme.

Ne kemi miratuar moratoriume, që pa dyshim janë të rëndësishëm, por kur vjen puna për aspektin financiar në fushën e mjedisit e kemi në një nivel jashtëzakonisht modest, të krahasueshëm me ndonjë OJF të fuqishme në Shqipëri.

Sot, gjithmonë e më shumë, problematika mjedisore po sensibilizohet edhe te njerëzit. Ne shikojmë në vende të ndryshme të botës që ndotja e ajrit, ujërave dhe tokës në përgjithësi po bëhet një problem akut, por në qoftë se këtu nuk rritet ndjeshmëria dhe të fillojmë sillemi ndryshe, por mbi të gjitha të investojmë, zor se do të ndodhë rehabilitimi i tyre.

Lidhur me këtë unë kam disa pyetje. Pothuajse të gjitha vendet e rajonit vlerësojnë në kohë reale cilësinë e ajrit urban, veçanërisht në qendrat e mëdha urbane, Shqipëria nuk bën pjesë, Prishtina e jep këtë informacion, ndërsa Tirana jo. Kur mund të parashikohet që edhe Tirana ta japë këtë?

Jam i bindur që qeveritë nuk do të japin para për mjedisin dhe është kjo arsyeja që institucionet ndërkombëtare, ka 25 vjet, që propozojnë krijimin e fondit për mjedisi dhe vetëm atëherë, nga taksat e mbledhura për mjedisin, të alokohet, të paktën një pjesë e atyre taksave të mbledhura, për problematikën mjedisore. A parashikohet që ky propozim, kjo nevojë, apo kjo domosdoshmëri të realizohet në Shqipëri? Pra, në studime të ndryshme, UNDP-ja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëre FMN-në.

Ne kemi marrë një vendim ligjor, atë të moratoriumit për gjuetinë, në një kohë që ka më shumë kërkesa për këtë dhe varet në vlerësimin e qeverisë se kur do ta hapë gjuetinë, por

a jemi në gjendje ne të japim sot, ose a është alokuar ndonjë fond për të vlerësuar censusin e faunës në Shqipëri, në mënyrë që ne të përcaktojmë se cila specie është e rrezikuar, cila nuk është, cila mund të gjuhet e të tjerë? Pra, a jemi në një fazë që mund të japim këtë lloj vlerësimi?

Së fundi, zhvillimi i turizmit është një element shumë i rëndësishëm dhe dihet që bashkë me zhvillimin e turizmit dhe me shtimin e miliona vizitorëve kemi një impakt jo të vogël në problematikën mjedisore, a mund të dimë kur parashikohet që vija bregdetare shqiptare të trajtojë ujërat e zeza në të gjithë vijën bregdetare, në mënyrë që të bëhemi vërtet atraktiv, por edhe të mos e rëndojmë më shumë situatën në momentet e ardhjes së disa milionave turistë, që, pa dyshim, në rrethanat kur nuk trajtohen ujërat e zeza, ata e agravanojnë situatën mjedisore dhe shëndetësore të ujërave bregdetare?

Faleminderit!

Niko Peleshi- Faleminderit, zoti Baraj!

Fjalën e ka zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Shkëlqesi Ministër, ju falënderojmë për informacionet e dhëna!

Dua t'ju adresoj dy pyetje.

Së pari, a keni parashikuar fonde në lidhje me pastrimin nga mbetjet e lumenjve? Po u referohem dy lumenjve, nga Erzeni deri në Ishëm.

Së dyti, lidhur me 36 gropat, që quhen të errëta, nuk dua t'u them të zeza, me mbetjet që vijnë nga diktatura, a keni parashikuar në buxhetin e vitit 2020 se sa para do të shpenzoni? Vota ime do të ishte pro nëse këto do të parashikohen në buxhet, besoj se edhe kolegët janë të interesuar.

Këto ishin dy pyetjet e mia.

Niko Peleshi – Zoti Nasufi, fjala për ju.

Fadil Nasufi- Duke qenë se po flasim për buxhetin, dua të konfirmoj atë që tha edhe ministri, që ministria e turizmit është një nga kontribuueset aktive në buxhetin e shtetit dhe shënon trend rritës në të ardhurat kombëtare, ndryshe nga gropa që ka krijuar energjetika apo impakti negativ që dhanë lojërat e fatit apo edhe largimi i investitorëve, si TAP-i. Kështu që dua ta përsëris për të gjithë këtë angazhim dhe trend rritës të turizmit në Shqipëri. Zoti Klosi dhe ministria kanë një shumë rol aktiv për promovimin e Shqipërisë, por edhe për ndërgjegjësimin publik për çështjet e mjedisit, të gjelbërimit, të pastrimit dhe për rritjen e kontributit të të gjithë shoqërisë që t'i rikthehet vetvetes për disa punë që janë bërë gangrenë dhe që nuk kërkojnë fonde, por më shumë kërkojnë ndërgjegjësim publik dhe aksion praktik

në terren. Ne kemi ndjekur disa raste aktive në Shqipëri dhe është një nga ministrinë më bashkëpunuese me ministrinë e tjera, qoftë me ushtrinë, qoftë me qeverisjen vendore, qoftë me Ministrinë e Arsimit për këto tradita të këqija që ne kemi për çështjet e pastrimit dhe të gjelbërimit. Edhe unë ndaj të njëjtin shqetësim apo të vërtetë të hidhur që fondet për këtë ministri janë shumë simbolike. Nuk mund të bëhen punët thjesht me vullnetarizëm, me task forca apo me kalendarë, të cilat e përmirësojnë gjënë, por që e riciklojnë prapë nëse nuk futemi në fushën e investimit.

Më bëri përshtypje fakti që tabelën që sjell Ministria e Financave e ka harruar fare si ministri dhe e ka renditur të 26. Ministria e Financave, pasi shprehet për të gjitha ministrinë e tjera, ku fut drejtorinë RTSH-së, Arkivin e Shtetit e të tjerë, kujtohet që ka edhe Ministri Turizmi dhe Mjedisi dhe jep 2 miliardë lekë të vjetër. Nga këtu shihet prioriteti apo vëmendja që duhet të ketë turizmi dhe mjedisi. Jam dakord me komentën që bëri zoti Baraj, që ne kemi miratuar paketa, ligje dhe akte të Këshillit të Ministrave, por që duhen mbështetur edhe me buxhete. Kur të kalojmë te diskutimi nën për nën duhet të shikojmë mundësinë se si do ta fuqizojmë edhe me buxhete.

Kam një pyetje lidhur me deklarinë që kemi bërë që në vitin 2017 për 100 fshatrat turistik. A ka një rol aktiv apo gjë konkrete për shndërrimin e këtyre fshatrave në atë ide, për të cilat ju lancuat, së bashku me ministrinë e tjera në këtë fushë?

Meqenëse ministrin e kam edhe drejtues politik në Berat, dua t'ju bëj një kërkesë juve, si kryetar komisioni, për t'i adresuar Ministrisë së Financave në lidhje me buxhetet vendore. Unë nuk e di kush thirret për buxhetet vendore këtu, por ka dy problematika që rezultojnë në Berat. Transferta e pakushtëzuar nuk e respekton numrin e popullsisë, Bashkia e Beratit ka 100.098 banorë, por trajtohet si bashki me 900 000 banorë. Popullsia nuk është se ka rritje natyrale, por banorët e Terpanit, e Lumasit, të Shejzës dhe të Vodicës janë pasaportizuar në Berat, sepse reforma territoriale, ashtu siç dha atë impaktin pozitiv, ka krijuar edhe kosto, sepse ai do të vijë një herë nga Terpani në Berat dhe nga Berati të kalojë në Poliçan për të kryer shërbime publike. Prandaj duhet të korrigjohet me çdo kusht transferata e pakushtëzuar për Bashkinë e Beratit, sepse këtu rezulton që e ka më të lartë Pogradeci dhe Divjaka sesa bashkia qendër qarku me popullsi.

Së dyti, ka ngelur një lloj klasifikimi për dendësinë e popullsisë dhe për klasifikimin e zonave malore, ku nuk e fusim koeficientin e përfitueshmërisë nga ky kriter i formulës së ndarjes së grantit të pakushtëzuar. Zotërinj, zona e Tomorrit është zonë super malore, është zonë me 19 fshatra që nuk njeh asnjë kilometër rrugë dhe është mali i tretë në Shqipëri, 2417 metra, të cilën e fut si zonë fushore dhe nuk përfiton koeficientin e mbështetjes me transfertë

të pakushtëzuar. Ndoshta këto janë pyetje për Ministrinë e Financave, por unë i bej këtu pyetjet, si bashkë kolegë që jemi, që duhet të reflektohen në këtë lloj financim buxheti. Ashtu siç shikoj që ndonjëherë nuk shikohen prioritetet tona përfaqësuese, por kanë të bëjnë ku është ministri i radhës atij i adresohen dhe fondet, kështu është edhe ndarja me qarqet. Qarku i Gjirokastrës ka 37 milionë lekë dhe i Beratit 33 milionë lekë, ku me këto 33 milionë lekë nuk do lajë dot borxhet e prapambetura që ka nga gjyqet, lëre pastaj të ndjekë dinamikën e përditshmërisë të aktivitetit administrativ dhe çfarë i ka thënë ligji.

Prandaj e mora fjalën këtu për ta bërë këtë sensibilizim, për të mos e ngritur në seancë plenare, për barazinë dhe trajtimin me ligj, jo privilegj, të kriterëve të ndarjes së granteve dhe të mbështetjes së pushtetit vendor, ashtu edhe për mbështetjen e ministrisë.

Faleminderit!

Niko Peleshi- Zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani- Faleminderit, kryetar!

Shumë faleminderit, zoti Ministër, edhe për prezantimin shumë të përmbledhur dhe përfshirës!

Dua t'ju falënderoja në mënyrë të veçantë për punën që keni bërë për rritjen e numrit të turistëve, në mënyrë të veçantë për promocionin e Shqipërisë si destinacion turistik në këtë kohë. Me thënë të drejtën këtë vit, pavarësisht se situata politika nuk ishte më e mira e mundshme, menduam që nuk do të kishim dhe aq turistë, në fakt, numri i turistëve tregoi që është rritur, po kështu edhe të ardhurat apo shpenzimet që ata bëjnë në Shqipëri ka sjellë edhe mundësi punësimi për qytetarët shqiptarë, edhe të ardhura për ekonominë.

Bashkohen me mendimin e kolegëve, edhe të relatorit Beqja, edhe të kolegëve të tjerë për sa i përket financimit të sektorit të turizmit. Në përgjithësi këto vite turizmi drejtpërdrejt është financuar në mënyrë modeste, ndërkohë që, patjetër është plotësuar me fondet e ministrive të tjera, duke zhvilluar infrastrukturën, agroturizmin, përmes IPARD-it, apo duke zhvilluar më shumë kujdesin shëndetësor për ta shpërndarë në gjithë Shqipërinë.

Ju keni një objektiv madhor për vitin tjetër, atë të rritjes së numrit të turistëve dhe, për sa i përket promocionit, edhe ajo do patjetër mbështetje financiare, si mendoni ta realizoni, çfarë hapash konkretë, jo domosdoshmërisht të shoqëruara me buxhet, ka ministria si praktika të mira të krijuara në këtë periudhë, dhe si mund t'i vazhdoni vitin tjetër, çfarë synimesh konkrete keni në fushën e turizmit? Unë e quaj një nga sektorët më prioritarë, të ardhurat që sjell në ekonomi janë goxha të larta, duhen rritur më shumë dhe mundësitë për punësim nga ky sektor janë shumë më të mëdha.

Pa dyshim, pyetja tjetër lidhet me Krujën. Edhe njëherë shumë faleminderit për promocionin që i bëni njërit nga qytetet më historikë edhe me një trashëgimi kulturore të pasur!

Unë gjithmonë kam merak, përveç promocionit të turizmit, ndotjen e mjedisit në bashkinë, nga e cila unë jam deputete. Gjej rastin t'ju falënderoj për mbylljen e guroreve, që i shkaktonin një dëm shumë të madh mjedisit, por sërish Kruja përballlet me ca probleme mjedisore, për të cilat do të doja vëmendjen tuaj të veçantë.

Faleminderit!

Niko Peleshi- Po, zoti Bitri.

Robert Bitri- Falënderoj ministrin për prezantimin, por sidomos për punën e bërë në vitin 2019 me promocionet për turizmin dhe luftës së madhe për pastrimin e Shqipërisë nga të gjitha ndotjet në të gjithë territorin!

Kam disa pyetje për zotin ministër. Është e vërtetë që Ministria e Turizmit ka pak fonde, por dua të di lidhur me mbrojtjen e mjedisit, për plehrat në qytetin e Fierit, ku jemi me investimin e madh që është bërë për djegien e tyre? Nuk e di nëse këto kalojnë nga ju apo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di, por pyetjen duhet t'ia bëjë ministrit të Mjedisit, sepse kur fryn erë treçereku i qytetit të Fierit ndotet dhe nuk mund të jetohet.

Së dyti, kemi disa ndërmarrje, që ju i keni nëpër rrethe. Në riorganizimin që ju do të bëni, kush do të përgjigjet për ndotjen e lumit Gjanica? Bashkia mund ta ketë shumë më të vështirë dhe është në presionin e investimeve që ajo nuk i ka, por nuk e di me këtë buxhet a i keni për të bërë kontrolle të vazhdueshme që lumi Gjanica të mos ndotet dhe as qyteti i Fierit?

E treta, kam një pyetje. Sa shtretër në Shqipëri janë aktivë dhe sa i keni ju të kualifikuara në sistemin e turizmit? Se ju e shihni në këndvështrimin e atyre që hyjnë e dalin, por sa nga këta janë aktivë? Mbase pyetja mund t'u bëhet edhe tatimorëve, por nëse ju e keni këtë shifër do të doja ta dija.

Mbase ne si komision, kur të vijmë në diskutimin nen për nen, duhet të ndikojmë në rritjen e buxhetit të Ministrisë së Mjedisit. Është domosdoshmëri, që si komision, i cili e kontrollon dhe e ndihmon, të ndikojmë tani me fakte konkrete dhe vota jonë të kushtëzojë në rritjen e këtyre fondeve.

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Zoti Ministër, ju lutem, të përgjigjeni sipas radhës së pyetjeve!

Blendi Klosi – E prisja nga ju edhe një pyetje, zoti kryetar, por me sa duket nuk jeni të interesuar për mjedisin!

Niko Peleshi – Kam diskutim, zoti Ministër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqë ju nuk po kërkonit fonde, qenkeni të kënaqur me buxhetin e turizmit. Kot e ngremë ne.

Blendi Klosi – Zoti kryetar, me eksperiencën shumë të gjatë, që kam në këtë tryezë, pra në jetën parlamentare, e vlerësoj shumë Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, kam qenë vetë anëtar i këtij komisioni, edhe në vitet e opozitës, dhe kemi bërë beteja në këtë komision. Unë vlerësoj që politikën që ne mund të ngremë nga ky komision dhe nga kjo tryezë parlamentare, janë më të rëndësishme se shifrat e buxhetit, pasi besoj se edhe ministri i Mjedisit të Japonisë, i Gjermanisë apo i SHBA-ve kur thirret në seanca parlamentare thonë që buxhetet janë të pamjaftueshme. Sot e gjithë bota flet për mjedisin dhe kërkon të shtohen investimet në këtë fushë, pasi ka të bëjë me jetën dhe jeta, gjithmonë e më shumë, po vlerësohet edhe në Shqipëri. Besoj se të gjitha pyetjet që u ndërtuan nga kolegët deputetë vijnë nga zona të ndryshme të vendit tonë, por me shqetësimin për jetën e njerëzve. Problematika është e njëjtë si ndotja në malin e Krujës, ashtu dhe ndotja e lumit të Gjanicës, si cilësia e ajrit në mes të qytetit të Tiranës, ashtu dhe cilësia e ajrit në Fier, si problematikat e guidës turistike të malit të Tomorit, ashtu dhe pastërtia e zonës së Valbonës. Për këtë arsye qeveria shqiptare ka shtuar në mënyrë marramendëse investimet si në industrinë e turizmit, ashtu dhe në industrinë e mjedisit.

Ju keni shumë të drejtë kur thoni që duhet të flasim për shifra konkrete që kanë të bëjnë me promovimin e këtyre dy sektorëve, prandaj jam këtu për të diskutuar me ju dhe për të parë mundësitë që, ato që bëhen jo vetëm nëpërmjet buxhetit të shtetit, por në një dakordësi shumë të madhe me institucionet qendrore, me institucionet lokale, me të gjithë shoqërinë civile, me donatorët, që nuk janë të pakët në këtë fushë, të mbrojmë objektivat tona madhore që kanë të bëjnë me promovimin e Shqipërisë turistike dhe me mbrojtjen e vazhdueshme të mjedisit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është ndërtuar e tillë që si mision parësor të saj të ketë mbrojtjen e ekuilibrit të qëndrueshëm, ndërmjet zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe të gjithë industrisë në vendin tonë, por dhe mbrojtjen e qëndrueshme të mjedisit.

Besoj se këtë ekuilibër duhet ta përkthejmë nën këto shifra buxhetore. Siç e thashë, si çdo ministër Mjedisit në botë, ndjej që ka nevojë për më shumë buxhet, por çdo gjë është relative, prandaj them që ndihem shumë mirë që shumë fusha të ekonomisë së vendit dhe

shumë investime që i përmendët në detaje, sidomos relatori Beqaj, shkojnë drejt turizmit dhe mjedisit.

A do të punojmë për ngritjen e një fondi për mjedisin? Kërkesat janë aq të mëdha dhe problematikat janë aq të shumta sa besoj që tashmë kemi shumë nevojë të fokusohemi qartazi edhe nëpërmjet buxheteve bashkiake.

Më bëri një pyetje deputeti i nderuar Gjuzi, se çfarë do të bëhet me pastrimin e lumenjve. Pastrimi i lumenjve nuk ka problem në vetvete. Lumenjtë në vendin tonë, duke qenë se janë të shkurtër, pra burojnë nga malet dhe derdhen në det, kanë pastërti të veçantë, por ajo çfarë ndodh gjatë rrugës me to i bën të papastër. Mund të flasim si të pastrohet lumi i Lanës dhe lumi Ishëm, apo lumi Gjanica, lumi Osum, por për sa kohë që vend-depozitimet e ish-komunave dhe të disa bashkive të vogla janë në shtretërit e lumenjve sikur një shi i vogël të bjerë, një pjesë e madhe e mbeturinave i çon nëpër gjithë shtretërit e lumenjve, në bregdetin shqiptar dhe i shpërndan në të gjithë Adriatikut. Kjo nuk ka nevojë të ketë një investim të plotë nga ministria, por bashkitë, edhe në kuadër të ndryshimeve ligjore, kur ne bëjmë Kodin Penal, duhet të kuptojmë që është vepër penale hedhja e mbetjeve urbane në vend jolegal dhe është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e çdo kryetari bashkie.

Sot, të 61 kryetarët e bashkive mund të penalizohen nga ligji për trajtimin jo si duhet të mbetjeve urbane dhe kjo është politikë, nuk ndodh sot, por ndërgjegjësimi për këtë punë, futja në Kodin Penal të kësaj e kësaj vepre penale, por edhe një studim që kemi bërë me shumë donatorë, do të na ndihmojë që një pjesë e madhe përgjatë vitit 2020 të trajtohet krejt ndryshe për sa u përket venddepozitimeve ilegale, venddepozitimeve pranë shtretërve të lumenjve dhe hedhja e mbeturinave në vendet e depozitimit të ish-komunave.

Është e pafalshme, e patolerueshme, por është fakt që bashki mëdha sot nuk kanë vend legal ku të hedhin mbetjet urbane.

Në lidhje me pyetjen e zotit Bitri, për sa i përket Fierit, investimi është realizuar dhe nuk ka arsye pse mbetjet urbane në të gjithë qarkun e Fierit të mos shkojnë në *landfill*-in e ri të përfunduar tashmë me standardet më të larta europiane, i licencuar dhe me leje mjedisore. Por të 7 bashkitë e qarkut të Fierit, kanë në kontratë që duhet t'i çojnë në *landfill*-in e ri të ndërtuar në Fier, që pastaj të kalojnë në incenerim. Kjo është detyrë që kryetarët e bashkive e kanë obligim. Nuk dua të them emra të përveçëm kryetarësh bashkish, por pothuaj të gjithë ngrenë duart dhe thonë “Por çfarë të bëjmë?”. Ata duhet ta zgjidhin këtë problem, është detyra e parë e një kryetari bashkie të pastrojë qytetin e tij. A do të bëhet me buxhetin e shtetit? Nuk i zgjidh dot buxheti i shtetit problemet e çdo bashkie.

Ndërkohë ne jemi në një bashkëpunim shumë të mirë me gjermanët, me zviceranët, me suedezët, me austriakët apo me BE-në për të investuar drejtpërdrejt në disa nga bashkitë e vendit, sidomos ato të nivelit të dytë dhe më poshtë për të trajtuar ndryshe venddepozitimet e mbetjeve urbane. A ka nevojë për buxhet? Sigurisht që ka. Nëse do të kemi mundësinë edhe gjatë negocimit nëpër komisionet parlamentare të shtojmë këtë zë të buxhetit, do të jemi fatlumë nëse në vitin 2020, edhe në kuadër të strategjisë “*Clean and green 2020*”, por edhe në kuadër të investimeve që bën Ministria e Energjetikës, e cila është ministria përgjegjëse për infrastrukturën e mbetjeve urbane, do të shkojmë në investime të vërteta për këtë problem të madh. Pra, nuk është se nuk ka zgjidhje, por është realiteti që na bën pis. Ne nuk jemi të ndotur, nuk kemi ndotës, ne kemi industri pothuajse miqësore me mjedisin, kemi 100% prodhim energjie bio, nuk kemi industri që të ndotë mjedisin, vetëm se kemi trajtim shumë të keq të mbetjeve urbane.

Politika jonë për të hequr qeset plastike nuk është vetëm kundër atij elementi, i cili realisht është ndotës. Buzë liqeneve dhe deteve shohim qese plastike, të cilat duhet të zhduken. Ka edhe probleme të tjera, si lumi Gjanica, për shembull, që ka papastërti nga ndotësit e mëdhenj të naftës dhe 6 milionë turistë, që hyjnë flasim kaq mirë për vendin tonë, por kur vijnë këtu flasim për papastërtitë. Ne nuk jemi të ndotur, por të papastër. Kjo është një lëvizje që duhet të marrë jetë edhe nga ky diskutim, por edhe nga diskutime të tjera, për t'i çuar në një stad tjetër politikat mjedisore në vendin tonë.

Çfarë bëhet me lumin Gjanica, pyet zoti Bitri. Pa dyshim që kemi probleme me mënyrën tashmë historike se si e trajton industria e naftës lumin Gjanica. Jemi në diskutime me këtë industri, e cila për hir të së vërtetës ka problematikat e saj të mëdha dhe gjithmonë e ka parë lumin Gjanica si venddepozitimi të mbetjeve që vijnë nga kjo industri. Lumi Gjanica është pastruar, por nuk është më i pandotur, sepse është pastruar aq bukur pjesa e Bashkisë së Fierit, por na duhet të shohim me Bashkinë, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe me Ministrinë e Energjisë realizimin e një diskutimi të hapur me investitorët e naftës për të kuptuar që duhet të ndryshojmë këtë realitet.

Unë them se kemi shumë nevojë që diskutimi për mjedisin të jetë shumë i fortë në jetën komunitare të vendit tonë.

Për sa i përket pyetjes së zotit Baraj për trajtimin e ujërave të zeza në zonat bregdetare është bërë një politikë e fortë karshi përdoruesve të vegjël dhe sot mund të themi pa frikë që nuk kemi përdorues dhe industri të vogla, si hotele, restorante, që kanë lidhje drejtpërdrejt me ujin, pra pa depurator, pa gropa septike. Ka ardhur koha që edhe gropat septike të eliminohen, por në një monitorim të vazhdueshëm që u bëjmë këtyre operatorëve, edhe në kuadër të

pajisjes së tyre me leje mjedisore dhe me depuratorë të vërtetë cilësorë të pastrimit të ajrit, kemi rritje shumë të madhe në këtë aspekt. Megjithatë vazhdon të ngelet shqetësuese mospërfundimi i veprave të mëdha të depurimit të ujërave të zeza në disa nga zonat tona bregdetare. Nëse kërkojmë që hotelet tona të ofrojnë shërbime me 4 apo 5 vje, nuk mund të pranohet që uji të jetë akoma i ndotur apo pa trajtim.

Megjithatë, e thashë edhe më lart, që është një problem madhor që ka nevojë për një fokus krejt tjetër. Qytetet bregdetare janë më të ndjeshmet, por edhe qytetet e mëdha, duke filluar nga kryeqyteti, nuk kanë trajtim të ujërave të zeza që shkojnë drejt lumenjve të Tiranës dhe pastaj drejt detit.

Ne kemi nevojë që në këtë aspekt të kemi një këndvështrim tjetër, paçka se e gjithë vija bregdetare, duke filluar nga Veriu në Jug ka marrë investime të konsiderueshme dhe zona ta tëra gjatë vitit 2019 dhe 2020 kanë pasur dhe do të kenë trajtim krejt tjetër të ujërave të zeza dhe ujërave të ndotura. Pra, vënia në punë e investimeve të mëdha në Durrës, në Sarandë, në Vlorë, në Himarë, në Shëngjin, dhe në zonën e Velipojës ka krijuar një sistem krejt tjetër të trajtimit të ujërave të zeza, por tashmë ka ardhur koha dhe qeveria po punon për një ligj të ri për të gjithë zonën bregdetare, të kuptojmë që kjo është një pasuri e bukur që na e ka dhënë Zoti, na e ka dhënë natyra të mbrojtur me të gjithë diversitetin e saj qoftë me detin Adriatik (deti i rërës), me detin Jon (deti u gurtë), me lagunat, me zonat e mbrojtura, me rezervatet natyrore të jashtëzakonshme, por që duhet të kenë një sistem mbrojtjeje dhe një trajtim krejt tjetër, edhe në mënyrën si i shfrytëzojmë gjatë stinës së verës.

Për këtë arsye po përgatitet një ligj i ri, që do të vijë shumë shpejt në parlament për trajtimin ndryshe të vijës bregdetare. Në këtë kuadër, të ardhurat që mblidhen nga kjo pjesë e industrisë, pra nga turizmi detar, duhet të ndihmojnë të ketë trajtim tjetër të ujërave të zeza, apo pastrimin në zonën bregdetare. Industria e detit, ose turizmi blu, është një prioritet yni, pasi duam shumë që ta hapim, duke sjellë më shumë ekonomi dhe më shumë biznes, duke shtuar në këtë mënyrë të ardhurat, mundësinë për punësim dhe për investim.

E gjitha kjo është ekonomi, domethënë çfarë investojmë ne nëpërmjet buxhetit për të krijuar me shumë ekonomi, punësim, mirëqenie, para për zonat bregdetare, për njerëzit, që jetojnë dhe mbahen nga ai biznes, si dhe për mundësinë e paraqitjes së Shqipërisë si destinacion i pastër, i qëndrueshëm dhe me nivel në botën e ekonomisë.

Kolegët Gjermani dhe Bitri bënë një pyetje në lidhje me promovimin turistik të zonave tona. Ne kemi një numër të konsiderueshëm hotelesh të reja në vendin tonë, shtretër të rinj janë shtuar nga Veriu në Jug, nuk ka një qytet të Shqipërisë që të mos ketë investime në biznesin e hotelierisë. Sot numërohen rreth 3700 hotele në vendin tonë.

Një nga detyrat që po ndërmerr Ministria është kategorizimi, regjistrimi dhe formalizmi i hoteleve për të pasur një statistikë më të plotë pasi unë jam dakord me atë që thotë zoti Beqaj se heqja e kufirit me Kosovën, realizimi i një minishengeni ballkanik, pra heqja e kufijve në komunikimin me vendet e Ballkanit, do të na ndryshojë komplet sistemin e statistikave dhe të marrjes së informacionit për sa u përket turistëve që hyjnë në Shqipëri. Ne sot e kemi ta bazuar statistikën në sistemin TIMS, pra në turistët që hyjnë në kufirin shqiptar. Janë pasaportat e huaja që qëndrojnë më shumë se 24 orë në vendin tonë. Me ndryshimet e këtyre regjimeve kjo statistike do të duhet të kalojë në nivel tjetër, pra se çfarë konsumohet realisht në hotelet shqiptare, çfarë më shumë në Shqipëri. Shifra 6 milionë e gjysmë turistë të huaj, ose vizitorë të huaj që vijnë në Shqipëri, do të pësojë ndryshime me këto ndryshimet e sistemit dhe të regjimit, me të cilin ne matim këtë statistikë.

Prandaj e mbështes zotin Bitri, kur thotë se në 6-mujorin e parë, në bazë të statistikave zyrtare, janë shtuar 227 hotele të reja nga Veriu në Jug. Nuk mjafton të themi që bregu i Durrësit tashmë është bërë një stacion i vërtetë investimesh në hoteleri, por se sa janë shtuar dhe çfarë duhet të bëjmë më shumë, sa netë flihet në këto hotele dhe çfarë të ardhurash ka.

Kjo është detyra e re që kemi kohë që po e punojmë me projektin e BB-së dhe besoj se viti 2020 do të jetë viti i zbatimit. Ne kemi realisht nevojë që shpejtojmë përpjekjet dhe të rrisim disbursimin e këtyre projekteve jo vetëm në investim, por edhe në politika nga projektet që kemi me donatorët.

Për sa i përket asaj që tha zonja Gjermani për malin e Krujës, besoj se ka qenë një nga përplasjet e mëdha me një komunitet të vështirë interesi, siç janë investitorët në fushën gurore, në malin e Krujës dhe malin e Tomorit, por ia kemi dalë me një punë të përbashkët me disa institucione dhe ministri që të bënim një bllokim të guroreve në malin e Krujës dhe të Tomorit si, pikat simbol të masakrimit të natyrës dhe të destinacioneve të tona turistike. Mali i Shenjtë i Tomorit dhe mali historik dhe superturistik i Krujës tani kanë një situatë të qetë, por ama kjo nuk mjafton, sepse kemi nevojë të rehabilitohen, të shndërrohen në zona të gjelbra, në zona turistike për të prodhuar më shumë para nga të dyja këto ndërhyrje, flas për bllokimin e industrisë, që ishte shumë agresive në të dyja zonat. Por a ia kemi dalë ta kemi pastër ajrin në Krujë? Aty kemi probleme të tjera mjedisore shekullore, se nuk janë investime të demokracisë, për sa i përket shfrytëzimit të kësaj pasurie natyrore, që është mali i Krujës nga pikëpamja e burimeve të gurit dhe gëlqeres, por besoj se jemi në rrugën e duhur dhe kemi arritje konkrete, të cilat as që mund të imagjinoheshin vite më parë. Ka qenë një përpjekje jo e lehtë dhe me disa problematika, si, për shembull, me prokurorë që hapin çështje pas çështje

për institucionet shtetërore, për vendimet qeveritare të marra, me hetime penale dhe me komunitete që luftojnë për të mbajtur atë perandori.

Por mendoj se ia kemi dalë të jemi të qëndrueshëm dhe transparentë dhe ajo që kemi realizuar në këto dy beteja është lufta për të qenë të ndershëm, duke mos i shkelur syrin njërit e duke lejuar tjetrin, por duke qenë të barabartë para ligjit. Mendoj se ky ka qenë çelësi i suksesit dhe do të doja shumë të kisha një ndërgjegjësim më të madh të opinionit publik, që të kuptojnë se lufta për mjedisin është shumë e vështirë në Shqipëri dhe nuk zgjidhet me buxhet, por me politika dhe duhet ta pranojmë që sot jemi shumë agresivë për sa i përket mjedisit dhe shumë pak të përgjegjshëm që kjo luftë është e përbashkët. Dëmtimi i mjedisit vazhdon të jetë një gjë që në mentalitet mund të tolerohet, ndërkohë që e gjithë bota ka kaluar në një stad tjetër.

Prandaj them që lufta kundër qeseve plastike, edhe pse e di që aty është një komunitet, i cili do ta kundërshtojë, se ka njerëz mosbesues, duhet të jetë një nga përpjekjet e vështira të vitit 2020, por besoj se do t'ia dalim me sukses.

1 Qershori, dita ndërkombëtare e fëmijëve le ta shënojë Shqipërinë si të parin vend evropian pa qese plastike.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit, zoti Ministër!

Besoj se të gjitha pyetjet morën përgjigje.

A ka diskutime nga anëtarët e komisionit?

Po mirë, bëjeni pyetjen. Më pas e kanë fjalën zotërinjtë, Bici, Konomi dhe Bare për komente dhe diskutime.

Urdhëroni!

Klajdi Qama – Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëndetje, zoti Ministër!

Ju folët për turizmin dhe për një rritje që pritet të ketë ky sektor me projektbuxhetin e vitit 2020, si dhe na përmendët ankorimin e jahteve. Një nga problemet për verën që lamë pas, sidomos për ata që vinin me jahte në Shqipëri, ishte ankorimi i tyre, një dukuri që e kemi dëgjuar shpesh, sidomos për ata që kanë kemi jahte në Shqipëri ky është stres më vete. Ne kemi pasur disa tentativa për ndërtimin e porteve të jahteve që nga vitit 1944, si porti gjerman, siç njihet në Durrës, deri në vitin 2015, ndërkohë që asnjë projekt nuk është realizuar, të gjithë kanë dështuar.

Dua të di nëse keni ndonjë projekt për ankorimin e jahteve. Nëse keni, a mjafton ky projektbuxhet për ta realizuar atë?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Bici.

Dritan Bici – Mendoj që përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit kanë informacion të plotë dhe ne na bëhet qejfi që turizmi nga viti në vit po bëhet një ndër zërat kryesorë i të ardhurave në buxhetin e shtetit dhe të qytetarëve në përgjithësi. Shohim që në bregdet janë bërë investime të fuqishme, si dhe na bëhet qejfi që të gjitha hotelet që ndodhen pranë vijës bregdetare janë të prenotuara nga turistët e huaj për 3-4 vjet., gjë që më parë, sidomos ata që patën investuar në hoteleri mallkonin veten e tyre, ndërsa tani investimet në hoteleri janë investimet më të suksesshme. E gjithë ky është si rezultat i politikave të qeverisë sonë.

Unë do të ndalem në një vend tjetër, sepse që të kemi një turizëm të suksesshëm, duhet të mbrojmë mjedisin, detin, rërën dhe pyjet. Pikërisht te pyjet dua të ndalem pak, duke denoncuar prerjen e pyjeve në rrethin e Gramshit nga një subjekt i licencuar, i cili e ka bërë këtë gjë më parë, por vazhdon edhe tani që është në fuqi moratoriumi i pyjeve. Ky person vazhdon prerjen e pyjeve sikur të mos ketë ndodhur asgjë, duke qenë personi përgjegjës, por edhe popullata në të njëjtën kohë. Siç e dimë, ekzistojnë vështirësitë ekonomike, kështu që fshatarët presin pyjet dhe filizat e rinj dhe natën turren këta me furgonë, sepse nuk i marrin më me makina të hapura, duke bërë transportin e druve. Shoh që kjo punë ka edhe një ngërç ligjor, sepse pyjet u kanë kaluar bashkive dhe pikërisht ato duhet të kujdesen për pyjet. Nuk e di nëse jam i informuar mirë nëse është detyrë e Inspektoratit ndalimi i prerjes së pyjeve apo jo? Qëllimi im është që të sensibilizohemi ndaj kësaj prerjeje të madhe pyjesh që po ndodh në rrethin e Gramshit.

Kam pasur rastin të vizitoj komunat e Kalabrisë, ato arbëreshe dhe shihja se atje njerëzit mbaheshin duke punuar nëpër pyje gjë të cilën nuk po e shohim më këtu te ne. Në kohën e monizmit ka pasur mbjellje të fidanëve pyjorë, të pishave e pemë të tjera, duke mbjellë sipërfaqe të tëra, ku një pjesë e tyre janë edhe sot, duke mbrojtur vendin nga erozioni. Kush do ta bëjë këtë punë tani? Në këtë kohë nuk po merret vesh se kush do të merret me pyjet, pasi një herë i kanë takuar Ministrisë së Bujqësisë, më pas Ministrisë së Turizmit, tani bashkive dhe ky është një problem shumë i madh.

Shohim kronika të tëra për Lurën, pyje të tëra që janë prerë dhe po ju them që jemi të vonuar për t'i zëvendësuar këto pyje, sepse duhet të ketë programe ekonomike të fuqishme për mbjelljen dhe zhvillimin e pyjeve. Lëvizja e njerëzve nga zonat rurale në drejtim të qyteteve të mëdha ka dhënë ndikimin e saj te pyjet, megjithatë këto vende me pyje kanë nevojë për proceset e tyre. Dua të di nëse këto investime do t'i bëjë Ministria e Mjedisit apo bashkitë?

Pra, nëse bashkitë kanë fonde dhe investime a janë në gjendje t'i bëjnë siç duhet? A i kanë fondet dhe specialistët e duhur? Nëse një specialist duhet të punësohen në ministri kjo bëhet në bazë të disa rregullave, gjë që nuk bëhet nga ana e bashkive, të cilat i punësojnë njerëzit si militantë e të tjera me radhë.

Për mua problemi i pyjeve është një problem i madh. Për mendimin tim pyjet në vendin tonë kanë qenë më mirë kur kishte një drejtori të përgjithshme dhe specialistë të mirëfilltë, të cilët bënin investime dhe pyjet ishin në gjendje të mirë. Tani nuk e di nëse pyjet i ka bashkia dhe specialistët i ka Ministria e Mjedisit dhe në këtë mënyrë nuk mund ta gjejmë se e kujt është përgjegjësia.

Pra, nëse ne duam të mos kemi përmytje nëpër fusha duhet që investimin ta fillojmë në mal dhe ky investim fillon duke mbjellë zonat që kanë erozion dhe bërjen e gabioneve mbrojtës. Në këtë periudhë fillon shiu në majë të malit dhe për 5 minuta vërshon Shkumbini, Erzeni apo Semani, kështu që pyjet dhe pritat malore i frenojnë këto procese. Vërshimi i lumenjve nuk ka ndodhur më parë, pasi ka pasur gabione rrethues, investime për zëvendësime e shumë gjëra të tjera, prandaj në këto momente dua t'ju kërkoj që kjo situatë të merret në dorë, pasi bashkitë nuk mund ta bëjnë dot, sepse nuk kanë personelin dhe fondet e duhura për t'i bërë këto investime në pyje.

Ju uroj suksese për vitin 2020 dhe jam i bindur që sektori i turizmit me politikat e Ministrisë së Mjedisit ka për të ecur akoma edhe më mirë.

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Bici!

Zoti Konomi e ka fjalën.

Më pas zoti Baraj.

Ardit Konomi – Kisha diçka në lidhje me hidrocentralet e vogla. Bëhet fjalë për një fenomen, i cili është ndërsektorial dhe përfshin shumë ministri, por mjedisi është ai që mbetet i dëmtuar në këtë mes, madje në këndvështrimin tim nuk ka fare të fituar. Po të shohësh efektet që kanë hidrocentralet me nga 1 apo 2 mega, ndërtimet e tyre me stabilimente të jashtëzakonshme betoni, ndikimi në ekonominë tonë kombëtare është pothuajse zero. Dua të di nëse ka ndonjë plan apo projekt për të parë gjendjen ku jemi me këto lloj hidrocentralesh dhe efektet që ata kanë? Sa zbatohet legjislacioni në fuqi nga ana e tyre në lidhje me rezervat ujore, të cilat duhet të lihen të lira dhe jo të jenë të kapura brenda sistemit të tyre të gjenerimit e kështu me radhë?

Dua t'ju bëj edhe një sugjerim. Ndoshta ka ardhur momenti të bëjmë ngrirjen e këtij procesi, tip moratoriumi, për këto hidrocentrale dhe t'i lëmë vetes kohë për të bërë një studim të detajuar dhe të mirëfilltë të të gjitha burimeve tona ujore, të kapaciteteve të tyre, të

ekosistemeve dhe gjithë zinxhirin që ato përfshijnë, duke filluar nga ekosistemi ujor, mënyra se si lidhen ato me ekosistemet e tjera tokësore të florës dhe të faunës dhe deri te ndikimet potenciale që kanë te komunitetet që preken. E para.

E dyta, besoj se ju jeni në dijeni që ka pasur një evazion të fortë të koncesionares së fundmi në zonën e malësisë së Korçës, kryesisht në pyjet e Vithkuqit, Moravës dhe Voskopojës. Para pak vitesh pati një luftë mekanike të koncesionares me disa efekte që u shtrinë në një kohë të shkurtër dhe tashmë jemi në fazën ku disa prej këtyre pyjeve, sidomos pyjet e reja të pishave janë në fazën e plotë të tharjes, sidomos në Malësinë e Moravës dhe Vithkuqit. Dua të di nëse ka ndonjë projekt në këtë drejtim.

Para disa ditësh isha në një forum që u bë për zonat e mbrojtura me specialistë dhe grupe interesi dhe nga ana e drejtorisë për zonat e mbrojtura të qarkut të Korçës u sugjerua që të kërkohej mbështetja e ministrisë dhe të provohej një insekt (insektofag), të cilit nuk ia kujtoj emrin, i cili është testuar që funksionon rreth 700 metra mbi nivelin e detit, por në pjesën e Korçës...

(Diskutime pa mikrofon)

Luftë biologjike...

(Diskutime pa mikrofon)

...800-850 metra deri në 1200 metra nuk e di ende, por mendoj se është një proces që ia vlen ta testojmë për të parë nëse ka efekt apo jo në mënyrë që të shpëtojmë nga lufta mekanike, i cili sido që të jetë do të ketë një rikthim të shpejtë në kursin kohor.

Faleminderit!

Besnik Baraj – Dua të përgëzoj në radhë të parë zotin ministër dhe ekipin që e shoqëron atë, të cilët me një buxhet kaq modest, kanë bërë vërtet një punë të jashtëzakonshme për rritjen e sensibiliteteve të opinionit publik dhe njëkohësisht për të gjitha iniciativat që keni ndërmarrë. Me të drejtë ju thoni që nuk është vetëm problemi i dëmtimit të burimeve të vendit tonë, por i sjelljes sonë si qytetarë ndaj mjedisit, ku ju përmendni veçanërisht mbetjet urbane që rëndom i shohim të hedhura anash rrugëve dhe kjo lidhet gjithmonë me sjelljen e qytetarëve. Në këtë kuadër dua t'ju them se ka një rëndësi mjaft të madhe bashkëpunimi juaj me Ministrinë e Arsimit për të pasur projekte të përbashkëta, për edukimin mjedisor veçanërisht në nivelet e shkollës elementare.

I bashkohem mendimit të zotit Konomi në lidhje me hidrocentralet e vogla. Tashmë i tërë komuniteti ku ngrihen këto hidrocentrale është kundër, gjë që tregon se ka pasur fiktivitet në marrjen e opinionit të komunitetit në lidhje me ndërtimin e tyre. Politika që kemi ndjekur ne për t'i stimuluar këto, duke u garantuar çmimin e blerjes, ka qenë faktori kryesor që i ka

nxitur këto për t'u zhvilluar. Në këtë kuadër i bashkohem asaj që tha zoti Konomi që ose të ketë një ngrirje ose të hiqet ky status favorizues në çmimin e blerjes së tyre, pasi vetvetiu ato ulin edhe kërkesën për ndërtimin e tyre. Është gjynah që në zona si Valbona u ndërtuan 2 apo 3 hidrocentrale të vegjëll, si edhe në zona të tjera, gjë që është në kundërshtim me opinionin masiv publik.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Çarçani.

Arlind Çarçani – Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Ministër,

Dua t'ju pyes nëse ka një plan konkret në rang kombëtar në lidhje me bashkitë për administrimin e mbetjeve urbane? Jam dakord me ju kur thoni se është përgjegjësi e bashkive, por a do të ishte më mirë të kishim një plan kombëtar dhe t'i detyronim bashkitë ta bënë më mirë punën e tyre?

Niko Peleshi – Zoti Jakimi.

Halil Jakimi – Zoti kryetar,

Të nderuar kolegë,

I nderuar zoti Ministër,

Do të ndalem shkurtimisht te sektori i pyjeve dhe dua t'ju bëj dy pyetje.

A e ka Ministria e Mjedisit inventarizimin kombëtar të pyjeve dhe nëse ka planifikuar të kryejë një inventarizim kombëtar, nëse është realizuar, sa është sipërfaqja e pyjeve aktualisht sot që jemi duke folur?

Kam lexuar një VKM për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, që do të jetë një strukturë tjetër, e cila do të fillojë nga zbatimi në janar të vitit 2020. Dua të di se si do të funksionojë Agjencia Kombëtare e Pyjeve, çfarë kompetencash dhe çfarë sipërfaqe do të mbulojë?

Unë vij nga qarku i Peshkopisë dhe qytetet që ndodhen në këtë qark si Bulqiza, Burreli dhe Klosi janë të ftohta. Dua të di diçka në lidhje me furnizimin e banorëve të këtyre zonave me lëndë drusore, kryesisht dru zjarri. Siç e përmendi edhe kolegu Bici, është vërtetë shqetësues furnizimi i këtyre banorëve me furgonë të mbyllur, me 3-4 metra kub lëndë drusore, duke shfrytëzuar kryesisht pyjet e reja, të cilat duhet të vlerësohen si lëndë punimi apo për shtylla minierash dhe jo të shfrytëzohen si lëndë zjarri.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zot Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

Dua të përfitoj nga rasti dhe të bëj një diskutim të shkurtër, duke filluar me një falënderim për ministrin, jo thjesht për parashtrimin që na bëri këtu për veprimtarinë e ministrisë që ai drejton gjatë vitit 2018-2019, por edhe çfarë parashikojnë për vitin 2020. Më vjen shumë mirë që shoh shifra me një rritje prej 10% për këtë vit, në këtë rast falënderimi shkon për ju, për stafin dhe administratën, e cila është impenjuar në këtë fushë. Ju dëgjova me shumë vëmendje se çfarë keni bëri dhe se çfarë do të bëni dhe jam dakord me ju për tri drejtime në të cilat duhet të jemi të vëmendshëm për rritjen e turizmit.

E para, po e nis me agroturizmin, për të cilin edhe në vitet që vijnë, edhe në paketat e shkuara fiskale, të paktën ne, si Kuvend, kërkesat që ju keni pasur, por edhe idetë që kemi diskutuar të gjithë bashkë këtu, i kemi dhënë agroturizmit mbështetjen e nevojshme dhe po fillojmë të shohim rezultatet e para në këtë fushë me 19 subjekte të regjistruara me status të agroturizmit.

Gjithashtu, jam dakord me ju që turizmi detar duhet të jetë një ndër sektorët, të cilin duhet të fillojmë ta konsiderojmë si një potencial të madh zhvillimi dhe rritje të drejtpërdrejtë të të ardhurave në fushën e turizmit.

Po ndalem pak më gjatë te çështja e sezonit turistik. Rritja prej 10% në vit e turistëve, sigurisht është një shifër shumë e mirë, por kam përshtypjen që në vend të numrit të rrisim akomodimin me 10%, edhe pse kjo është diçka e vështirë. Investimet në këtë fushë besoj se nuk do të arrijnë të rriten me 10%, gjë që na bën dhe na detyron në njëfarë mënyrë të bëjnë politika të tilla, të cilat mund të na e zgjasin sezonin turistik. Numrin në rritje të turistëve nuk duhet ta kërkojmë vetëm në një sezon veror, por ta shtrimë ndër vite dhe këtu bie dakord me politikat që thatë ju, si diversifikimi i ofertave.

Dua t'ju them diçka në lidhje me mjedisin. Sigurisht, mjedisi ka nevojë për buxhetin e tij, por në të njëjtën kohë jam dakord me atë që thatë ju, se është çështje kulture dhe këtu duhet të përqendrohemi. Gjithsesi, çfarëdolloj mbështetjeje që ju do të kërkonin nga ana e komisionit tonë në këtë aspekt nuk do t'ju mungojë asnjëherë. Në prill të këtij viti kam qenë në një ekspozitë fotografie "Planeti" apo "Plastika" e organizuar nga National Geographic dhe aty mësova krejt rastësisht, që ndotësi më i madh i ambientit janë tullumbacet. Të gjithë kemi fëmijë dhe blejmë tullumbace për ta, kështu që duke u nisur nga ky fakt, duhet të impenjohemi për të ndihmuar në mbrojtjen e ambientit.

Këtë jua thashë pikërisht për të mbështetur idenë që thatë ju se më shumë sesa buxhet mjedisi ka nevojë për kulturë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Diskutime të tjera nuk ka.

Para se ministri të bëjë mbylljen, sepse seanca ishte parashikuar deri në orën 12:00 dhe më pas kemi një dëgjese tjetër me Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës, kam disa gjëra për të thënë.

Jam shumë dakord dhe dua të përgëzoj punën e ministrit, i cili nuk e ka të lehtë të drejtojë dy sektorë që duket sikur janë në harmoni, por janë edhe komplementarë, shpeshherë edhe në konflikt interesi me njëri-tjetrin. Jam dakord me zotin Pëllumbi, që mjedisi kërkon sensibilizim, kulturë, edukatë qytetare, por mbi të gjitha kërkon buxhet të jashtëzakonshëm.

Po ashtu ka edhe disa gjëra, siç u shpreh ministri, që bëhen pa shumë buxhet, prandaj mendoj se është e rëndësishme të qartësojmë politikën e mjedisit, më shumë edhe për t'ju treguar bashkive se çfarë rruge duhet të ndjekin, sepse shpeshherë ato marrin mesazhe kontradiktore. Duke qenë se nuk ka një politikë shumë të qartë lokale, vendore, se ku ia vlen të investohen bashkitë. Të investohen në ndërtimin e inceneratorëve apo të investohen te landfillet? Të investohen te riciklimi apo riciklimi nuk është një proces që mund të realizohet në Shqipëri përveç stadi të zhvillimit ku jemi? Cila është masa kritike që mund ta bëjë një incenerator vizibël, sepse ne kemi një model të Elbasanit, po ndërtohen dy të tjerë, dhe mbase bashkitë marrin mesazhin që kjo është rruga, por të paktën për njohuritë që kam, një bashki e vogël nuk mund të mbajë një incenerator. Tirana e ka të mundur, por nuk e di për Fierin dhe Elbasanin sesi do të shkojë, por bashkitë e tjera më të vogla, në dijeninë time, e kanë të pamundur. Mos ndoshta duhet ta bëjmë pak më të qartë politikën orientuese për bashkitë që të shkojnë drejt landfillëve, që është zgjidhja më e eficiente dhe e përshtatshme për nivelin e buxheteve tona? Në qoftë se po, cili është modeli që duhet të ndjekin?

Mund të ndaj me ju një projekt pionier në qarkun e Korçës, që është një landfill, i cili operon për të gjitha bashkitë e rajonit, që është bërë aksioner në një shoqëri të përbashkët që menaxhon një landfill.

Nga ana tjetër, ju përmendët sanksionet për kryetarët e bashkive, por, në qoftë se ata nuk kanë mundësi financiare të bëjnë zgjidhjen e menaxhimit të mbetjeve urbane, sado sanksione t'i vendosësh kryetarit të bashkisë, ai nuk ka çfarë të bëjë. Më kujtohet në kohën kur ka qenë dikush tjetër ministër Mjedisi, unë kam qenë kryetar bashkie, u ka vënë gjobë 10 milionë lekë të gjithë kryetarëve pse nuk zgjidhëm brenda vitit menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, që ishte qesharake. Domethënë, nga koha kur doli ligji e deri te gjoba, ishin disa muaj dhe brenda këtyre muajve kryetarët e bashkive duhet të kishin ndërtuar landfillet dhe të kishin siguruar menaxhimin e integruar të tyre. Pra, nuk bëhet vetëm me sanksione, për mendimin tim, ne duhet të japim mesazhe shumë të qarta orientuese dhe mbështetje

buxhetore për bashkitë, sepse unë përmenda landfillin e Maliqit, por ai ka kushtuar 10 milionë euro, që për 10 mijë vjet bashkitë e atij qarku nuk do ta kishin të mundur ta ndërtonin po të mos ishte mbështetja buxhetore, juaja, zoti Ministër, sepse në kohën tuaj filloi funksionimi dhe është një nga projektet model në rajon, jo vetëm në Shqipëri. Them se duhet t'i promovojmë më tepër këto modele suksesi edhe për të orientuar bashkitë.

Sa i përket turizmit, ne si komision na takon ta vëmë theksin në sektorin e turizmit. Ai është një prej degëve të rëndësishme të fushës me të cilën merret ky komision dhe ka të bëjë drejtpërsëdrejti me ekonominë e vendit, tërheq pas vetes shumë sektorë të tjerë si bujqësia dhe industritë e tjera përpunuese. Pra, është biznes që eksporton kryesisht shërbime dhe produkte, ka rritje të jashtëzakonshme, shumë më të madhe sasa bujqësia, që është sektori kryesor i vendit dhe përbën 20 % të GDP-së. Duke qenë një sektor produktiv, nuk mund të ketë më pak financim sesa, për shembull, menaxhimi i administratës publike, pra, shpenzimet për menaxhimin e administratës publike janë 50% më të larta se shpenzimet për turizmin; shpenzimet për prefekturat janë 35 % më të larta sesa zëri në buxhet për turizmin. Nuk dua të them se këta sektorë nuk janë të rëndësishëm, por ne jemi Komisioni i Veprimtarive Prodhuese dhe na intereson t'i llobojmë aktivitetet produktive prodhuese që ato të furnizohen më tepër. Kështu që brenda hapësirës dhe mirëkuptimit me qeverinë, me ministrin e Financave, me komisionet e tjera, kur ta diskutojmë nen për nen, më vjen mirë që e thanë të gjithë, do të përpiqemi të gjejmë hapësira për ta financuar më mirë, por edhe për të qenë më optimistë, turizmi nuk është një sektor që duhet të furnizohet vetëm përmes Ministrisë së Turizmit, i shërbejnë edhe sektorët e tjerë.

Në dëgjuesë kemi ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, që mesa shoh ka buxhete të mjaftueshme për investime në infrastrukturë dhe energji, që në mënyrë indirekte japin impakt në turizëm, apo Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili ka fonde shumë të mira qoftë për 100 fshatrat, qoftë për investime të tjera që, gjithsesi, për t'i parë në total, duhen parë si investime për turizëm, gjithashtu.

Zoti Ministër, një fjalë përmbyllëse, në qoftë se keni dhe konkluzionet e fundit duke prekur ndonjë pyetje që u ngrit dhe ende s'ka marrë përgjigje.

Blendi Klosi – Faleminderit, kryetar!

Besoj se çdo diskutim i kolegëve deputetë dëshmon që ata janë në këtë komision me ndjesi që vijnë nga baza dhe realiteti. Asnjë nga vërejtjet që iu drejtuan Ministrisë së Mjedisit nuk janë opozitare negative, por pozitive. Pra janë shqetësime reale të realitetit shqiptar. Kjo më bën të ndjehem mirë edhe për faktin që, siç e thanë edhe kolegë këtu, pak kohë më parë, ndoshta vite, nuk bëhej fjalë fare që të kishim një reaksion qytetar për sa i përket ndërtimit të

një heci, një gurorëje apo të kishin pafuqinë e realitetit kundër mjedisit. Sot është pothuaj e pamundur të bëhet një ndërhyrje në natyrë apo në mjedis pa pasur një reaksion qytetar apo ballafaqim me komunitetin.

Ky diskutim që po bëhet sot, po të transmetohet live, çdo fjalë është një thirrje për të qenë më pranë asaj që njerëzit duan dhe kërkojnë të ndodhë në Shqipëri për sa i përket mjedisit.

Komenti i parë i zotit Qato ka të bëjë me marinat. Është e vërtetë që ne nuk kemi investime të mëdha në to, por, në qoftë se do të presim vetëm që të ndodhin ato, duke parë modelet e vendeve të zhvilluara të rajonit pranë nesh, si Kroacia, Mali i Zi, Greqia, Italia, Sllovenia, Turqia, vendet e Mesdheut janë të gjitha shumë të zhvilluara, por jo vetëm falë marinave të mëdha.

Siç e tha edhe kolegu Beqaj, tashmë 3-4 marina janë në fazën e plotësimit të dokumentacionit për të filluar investimet nga Veriu në Jug, nga Shëngjini në Durrës, në zonën e Spillesë, Vlorës dhe Sarandës. Por a mjafton kjo? Unë mendoj që të paktën për Ministrinë e Mjedisit, se për pjesën e investimeve është Ministria e Infrastrukturës, duhet të krijojmë një komunitet që e do të drejtën në Shqipëri, pra njerëz që i shërbejnë, që e shfrytëzojnë, njerëz që dinë të lundrojnë, që dinë t'i shërbejnë marinës, pra të krijojmë një komunitet tjetër që nuk e kemi sot në Shqipëri. Familjet e vogla që e duan detin, që lundrojnë apo jetojnë në det, në vendin tonë pothuaj janë zero, falë komunizmit apo edhe këtyre viteve të demokracisë kur deti ishte i ndaluar me moratorium për 8 vjet që të mos lundrohej. Pra, është një kulturë e munguar dhe prej kësaj ne duhet të hapim bisedimet për turizmin blu, pra jo vetëm të presim deri sa të bëhet marina e madhe që do të pranojë varkat nga të pasurit, por çfarë do të bëhet edhe me shtresën e mesme, njerëzit që jetojnë me detin. Kjo është politika e re për të cilën dua të flas.

Po ashtu edhe shqetësimi i zotit Bici për sa u përket pyjeve, për subjektin që ju flisni, të nderuar deputetë, është një subjekt koncesionar, i cili ka një koncesion të dhënë nga ish-Ministria e Mjedisit tashmë të implementuar nga Bashkia e Gramshit, e cila është poseduese e pyjeve. Në Shqipëri janë 9 koncesione, të cilat janë aktive, pasi moratoriumi u vendos përveç koncesioneve që ishin me kontrata të lidhura. Edhe ky është një debat i madh në Shqipëri, por unë ndjehem mirë që moratoriumi i pyjeve e ka hequr industrinë e prerjes së pyjeve në Shqipëri.

Natyrisht, nëpër foto dalin kamionë apo furgonë me lëndë drusore, por ato janë të gjitha të licencuara nga bashkitë për ngrohjen me lëndë drusore. Pra, ne kemi ndërprerë industrinë dhe falë kësaj ndërprerjeje realisht ndjehemi mirë se është shtuar shumë sipërfaqja

e pyllëzuar në Shqipëri me problematikat e saj, por për të parë se si funksionojnë koncesionarët, siç e thashë, është përgjegjësi mikse, sepse tashmë u ka kaluar bashkive, por Inspektorati i Mjedisit dhe Turizmit do të jetë shumë më tepër aktiv në monitorimin e këtyre koncesionarëve që, pa dyshim, kanë mëkatet e tyre në zbatimin e kontratave që kanë me shtetin shqiptar.

Pyetja më pas lidhej me ligjin e ri për pyjet. Tashmë ky ligj ka kaluar aprovimin qeveritar dhe besoj se pas buxhetit të shtetit do të kemi një diskutim në komisionin tuaj për sa i përket këtij fenomeni për atë çfarë po ndodh me ligjin e ri të pyjeve apo çfarë ndodh për ngrohjen drusore nga bashkitë sa u përket nevojave të komunitetit, që e ngritën edhe kolegët e tjerë. Në kuadër të moratoriumit, besoj se jemi të suksesshëm, sepse kemi ndaluar industrinë e prerjes së pemëve, të cilat e dëmtonin pa masë realitetin.

Politikat tona për mbjelljen e më shumë pemëve, politika, të cilat vijnë edhe nga situata globale, që ka të bëjë me ngrohjen globale dhe ndryshimet klimatike, na shtojnë hapësirën për t'i kërkuar komunitetit të mbjellin më shumë pemë. Tashmë pyjet kanë kaluar në pronësi të bashkisë dhe shteti nuk është më qendra që ndjek politikat e pyjeve, por bashkitë janë poseduesit e tyre.

Projekti i Bankës Botërore për regjistrimin e pyjeve, ishte një pyetje tjetër e një deputeti. Po përfundon inventarizimi i pyjeve dhe projekti i kësaj banke, i shtrirë në të gjithë Shqipërinë, është një projekt, i cili realizon bazën e të dhënave për pyjet shqiptare dhe të gjithë *database*-n e pyjeve, po ashtu, po inventarizon pyjet në shkallë vendi. Është në fazën e implementimit dhe është një nga projektet e suksesshme të Bankës Botërore.

Për të shkuar te një grup pyetjesh që vijnë nga kolegët për sa i përket mbrojtjes së mjedisit dhe trajtimit të mbetjeve urbane, unë vet personalisht kam qenë në 61 bashkitë e vendit dhe i kemi trajtuar këto problematika. Është e vërtetë ajo që thotë zoti Peleshi që bashkitë nuk janë aq të forta sa duhet për të trajtuar mbetjet urbane të vetme. Po ashtu, ka një vendim të Këshillit të Ministrave për bashkitë që nuk e zbatojnë atë, që kërkon një përlllogaritje të kostove dhe tarifave ashtu siç duhet. Është për të ardhur keq që një pjesë e konsiderueshme e bashkive të vendit nuk trajtojnë mbetjet urbane në bazë edhe të këtij vendimi për të përlllogaritur sesa kosto i duhen çdo bashkie për trajtimin e mbetjeve urbane.

Është modeli i Korçës, por nuk është i vetëm. Korça ka një landfill të ri tashmë, por bashkitë e qarkut të saj nuk mund të vazhdojnë të harxhojnë paratë se kështu kanë qenë përlllogaritjet para disa viteve për trajtimin e mbetjeve urbane pa asnjë llogaritje të kostove. Kostoja është atje, paratë mblidhen nga buxheti i bashkive apo nga buxheti qendror, por ama përlllogaritja e kostove çalon pothuaj në të gjitha bashkitë. Është një landfill i Korçës, ai i

Maliqit, të gjitha bashkitë e tjera janë të detyruara të shkojnë aty me stacione tranzitore, por ama të llogarisin koston që iu duhet, sa para ju duhen dhe të jenë real në llogaritjet që bëjnë. Ne nuk mund të pranojmë që të paktën pas atyre që dalin nga përllogaritja e kostove të jemi dy-trefish më shumë sesa kostoja e vërtetë e mbetjeve urbane që prodhojnë qytetet tona.

Fieri e ka investimin e realizuar, Elbasani, gjithashtu, Berati po merr një investim nga projekti zviceran, landfilli i Vlorës po realizohet, landfilli i Bajkanit për zonën e Gjirokastrës është realizuar, landfilli i Bushatit është realizuar, por ama të dyja qarqet Lezha dhe Shkodra duhet të shkojnë në atë landfill, vendin e kanë, menaxhimin e kanë, duhet të përllogarisin kostot dhe të fillojë një mënyrë tjetër përllogaritjeje. Është shumë e kollajtë për një bashki t'i hedhë plehrat buzë lumit dhe lumi t'i marrë t'i çojë në det, por kjo nuk është politikë që mund të ndiqet në vitin 2020.

Meqenëse është një temë kaq sensitive, do të kërkoja dakordësinë e komisionit, që pas diskutimit të buxhetit, që është shumë impenjativ, të vij në komisionin tuaj t'ju paraqes situatën për 61 bashkitë e vendit, cilat janë vend-depozitimet që duhet të mbyllen, cilat janë vend-depozitimet që duhet të rehabilitohen, cili është sistemi i menaxhimit të mbetjeve urbane, si i kemi kostot, tarifat, se dakord tarifa bëhet nga qytetarët, por në 61 bashkitë e vendit është e vështirë të gjejmë një tarifë të barabartë, ato kanë sistem të tyre të vendosjes së tarifës karshi qytetarëve. Në një qark të vetëm, të pesë apo gjashtë bashkitë kanë diferencë me herë me njëri-tjetrin për tarifën karshi qytetarëve dhe kjo ka ndodhur ngaqë askush nuk është marrë me të tërën. Ndaj kërkesa jonë si ministri, më falni që e zgjas, por besoj se është momenti ta diskutojmë edhe në komision, është se cila është situata. Janë gjëra, të cilat janë të paimagjinueshme që ndodhin ende. Detyra e bashkive nuk është vetëm pastrimi i qendrave të qyteteve. Unë kam një studim të detajuar për të.

Lidhur me hecet e vogla ne jemi në fazë moratoriumi të pashpallur sa u përket atyre. Është bllokuar sidomos ajo nën 2 mega për dhënie të lejeve të reja minerare. Së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës, po ndërtojmë tashmë një grup të përbashkët me disa ministri dhe shumë institucione për të bërë një masterplan të zonave ku mund të realizohen hecet e mëdha apo të vogla në vendin tonë, pasi, siç e thashë, ne kemi një sistem hidrik bionatyror, i cili nuk dëmton mjedisin, por nga ana tjetër, komunitetet janë bërë shumë më tepër agresive për sa u përket këtyre investimeve, që në disa raste janë jashtë logjikës reale ekonomike, por edhe që dëmtojnë shumë peizazhin.

Në dy vjet e gjysmë që jam ministër nuk kam firmosur asnjë hec në zonat e mbrojtura, por për sa u përket zonave të tjera, ka ardhur koha që ose të bëjmë një

moratorium, ose të bëjmë një analizë të plotë si është situata dhe ku do të jetë e mundur që këto hece të mos dëmtojnë realitetin jo vetëm jetësor të komunitetit, por edhe natyror, hidrik dhe shumë problematika që lidhen me investime të çuditshme që përfiton një njeri, por që dëmton një shkallë shumë më të gjerë.

Niko Peleshi - Ju falënderoj, zoti Ministër, për prezencën dhe për të gjitha sqarimet e detajuara!

Ju uroj punë të mbarë!

Ne do të vazhdojmë angazhimet tona lidhur me lobimin për të përmirësuar financimet në buxhet, ndonëse, siç e thatë edhe ju, të gjitha politikat tuaja edhe ambiciet për vitin që vjen, sidomos ambicia që duhet të kthehet kombëtare për ta futur Shqipërinë në hartën e vendeve pa qese, janë të financuara në këtë buxhet, janë të mundura, dhe mbi të gjitha janë të udhëhequra nga vullneti dhe planet tuaja për t'i bërë realitet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA